

DEKLARATA E PARIMEVE TË PAVARËSISË SË GJYQËSORIT

nga

KONFERENCA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE TË LARTA TË EVROPËS QENDRORE
DHE LINDORE

Brijuni, KROACI

14 Tetor 2015

PREAMBULA

DUKE PASUR PARASYSH që *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike* garanton të gjithë personat duhet të kenë akses në një gjykatë kompetente, të pavarur, dhe të paanshëm për zgjidhjen e padive civile apo akuzave penale.

DUKE PASUR PARASYSH që *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut* parashikon se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë të ligjit.

DUKE PASUR PARASYSH që *Kongresi i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e të Dënuarve* ka deklaruar se pavarësia e gjyqësorit do të garantohet nga shteti dhe do të mishërohet në Kushtetutë apo ligjin e vendit.

DUKE PASUR PARASYSH që *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut* kërkon nga shtetet nënshkruese që t'i garantojnë kujtdo brenda juridiksionit të tyre të drejtën e jetës, lirisë, sigurisë dhe të drejtat dhe liritë e tjera, të renditura në Titullin I të Konventës, duke përfshirë të drejtën për të pasur një proces të rregullt ligjor, prej një gjykate të pavarur të paanshme të krijuar me ligj.

DUKE PASUR PARASYSH që Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian ka njohur në opinionet e tij se pavarësia e gjyqësorit është një parakusht thelbësor për funksionimin e drejtësisë.

DUKE PASUR PARASYSH që këto të drejta mbrohen edhe nga instrumente të tjera rajonale dhe Kushtetutat, ligjet, vendimet gjyqësore, dhe nga marrëveshjet e vendeve pjesëmarrëse.

DUKE PASUR PARASYSH që pavarësia e gjyqësorit nuk është një privilegj i tij, por një detyrim që rrjedh nga e drejta e çdo individi për një gjykatë të paanshme.

DHE DUKE PASUR PARASYSH që zbatimi dhe mbrojtja e të gjitha të drejtave varet nga ekzistenca e një gjyqësori të aftë profesionalisht, të pavarur, dhe të paanshëm.

PARIMET E MËPOSHTME vendosin standarde si për pavarësinë e gjyqësorit, një nga tre degët e pushtetit shtetëror, ashtu dhe për pavarësinë e çdo gjyqtari. Këto parime përfaqësojnë angazhimin e plotë të Konferencës së Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore për shtetin e së drejtës dhe synojnë të udhëheqin çdo gjyqtar në përmbushjen e përgjegjësiave të rëndësishme gjyqësore, të ndihmojnë gjyqësorin në vetë-rregullim, të vendosin bazën për diskutim mes tre degëve të pushtetit, dhe të promovojë respektin e publikut dhe vlerësimin për gjyqësorin.

PAVARËSIA E GJYQËSORIT

1. Gjyqësori është një institucion më vlerën më të lartë në çdo shoqëri.
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Neni 10), Pakti Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (neni 14 (1)), dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Neni 6 (1)) shpallin se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj. Një gjyqësor i pavarur është i domosdoshëm për realizimin e kësaj të drejte.
3. Pavarësia e Gjyqësorit kërkon që:
 - a. Gjyqësori duhet të vendosë për çështjet para tij, në përputhje me vlerësimin e paanshëm të fakteve dhe kuptimin që ka për ligjin pa ndikime të papërshtatshme, direkte apo indirekte, nga çdo burim;
 - b. Pavarësia i takon si institucionit të gjyqësorit, ashtu dhe çdo gjyqtari në lidhje me një çështje që i caktohet atij; dhe
 - c. Asnjë gjyqtar nuk mund të gjykojë siç duhet për shkak të frikës apo ndonjë përfitimi të pritshëm nga çdo burim, apo për shkak të ndikimit të papërshtatshëm.
4. Ruajtja e pavarësisë së gjyqësorit është thelbësore për arritjen e objektivave të tij dhe përmbushjen e duhur të funksioneve të tij në një shoqëri të lirë duke respektuar shtetin e të drejtës.
 - a. Gjyqtarët duhet të tregojnë dhe të promovojnë standarde të larta të njohurive ligjore dhe sjelljes gjyqësore, me qëllim për të forcuar besimin e publikut në gjyqësor, i cili është themelor për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit.
 - b. Paanshmëria dhe dukja e paanshmërisë janë thelbësore për kryerjen e duhur të detyrës gjyqësore. Ato zbatohen jo vetëm për vendimin në vetvete, por edhe ndaj procesit përmes të cilit vendimi jepet.

5. Pavarësia e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve duhet të garantohet nga shteti dhe duhet të sanksionohet në Kushtetutë, në nivelin më të lartë ligjor të vendit. Rregulla më specifike duhet të parashikohen në nivelin legjislativ.
6. Është detyrë e institucioneve të shtetit që të respektojnë dhe zbatojnë objektivat e duhura dhe funksionet e gjyqësorit.
7. Në procesin vendim marrës, detyra e gjyqtarit gjatë ushtrimit të pushtetit individualisht apo bashkë me gjyqtarë të tjerë, në dhënien e vendimit në përputhje me nenin 3 (a) nuk do të jetë objekt ndërhyrje apo ndikim nga çdo gjyqtar që nuk gjykon çështjen, nga Këshilli i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, apo ndonjë funksionar ose institucion të qeverisë, përveç kur vendimi mund të apelohe në një gjykatë tjetër. Gjyqësori duhet të ushtrojë funksionet e veta në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Shteti duhet të parashikojë procedurat dhe mjetet juridike për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit, duke përfshirë ndëshkime ndaj atyre që përpiqen të ndikojnë tek gjyqtarët, përveç se përmes proceseve gjyqësore të ligjshme.
8. Gjyqtarët duhet të mbështesin integritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit dhe fitojnë besimin e popullit duke shmangur sjellje të pahijshme dhe shfaqjen e sjelljes se pahijshme në të gjithë veprimtarinë e tyre zyrtare dhe private.
9. Për aq sa përshtatet me detyrat e tyre si pjesë e gjyqësorit, gjyqtarët, ashtu si qytetarët e tjerë, kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, besimit, organizimit dhe tubimit, me përjashtim të rastit kur gjyqtari duhet të shmanget nga aktiviteti politik.
10. Gjyqtarët duhet të jenë të lirë, subjekt të çdo ligji në fuqi, për të formuar dhe për t'u bashkuar në një shoqatë të gjyqtarëve për të përfaqësuar interesat e tyre dhe promovuar trajnimin e tyre profesional dhe për të ndërmarrë veprime të tjera të përshtatshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre.

OBJEKTIVAT E GJYQËSORIT

11. Objektivat dhe funksionet e gjyqësorit përfshijnë si më poshtë:

- a. të sigurojë, brenda kufijve të duhur të funksionit gjyqësor, që të gjithë personat janë në gjendje të jetojnë të sigurt sipas shtetit të së drejtës në një shoqëri të rregulluar nga ligj;
- b. të promovojë, brenda kufijve të duhur të funksionit gjyqësor, respektimin dhe arritjen e të drejtave të njeriut; dhe
- c. të zbatojë ligjin në mënyrë të paanshme mes personave fizik dhe personave juridikë dhe mes personave fizikë e personave juridikë dhe Shtetit.

EMËRIMI I GJYQTARËVE

12. Për t'i mundësuar gjyqësorit që të arrijë objektivat dhe të kryejë funksionet e tij është thelbësore që gjyqtarët të zgjidhen sipas meritës, bazuar në aftësitë profesionale, integritetin dhe pavarësinë të provuara .

13. Metoda e emërimit të gjyqtarëve duhet të jetë e tillë që do të sigurojë emërimin e personave të cilët janë më të kualifikuarit për detyrën e gjyqtarit. Ajo duhet të sigurojë garanci nga ndikimet e padrejta duke marrë parasysh që emërohen vetëm personat të aftë profesionalisht, me integritet dhe të pavarur.

14. Në përzgjedhjen e gjyqtarëve nuk duhet të ketë diskriminim kundër një personi për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimit politik apo çdo mendimi tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, statusit martesor, orientimit seksual, pasurisë, lindjes ose pozitës, me përjashtimin se nuk do të konsiderohet diskriminues kushti që një kandidat për pozicionin e gjyqtarit duhet të jetë shtetas i vendit në fjalë.

15. Promovimi i gjyqtarëve duhet të bazohet në një vlerësim objektiv të faktorëve të tillë si aftësi profesionale, integriteti, pavarësia dhe përvoja.

16. Procesi për përzgjedhjen, emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve duhet të jetë transparent. Me qëllim sigurimin e transparencës së procesit të përzgjedhjes, ligji duhet të përcaktojë qartë procedurat dhe kriteret objektive për përzgjedhjen e gjyqtarëve.

KOHA E QËNDRIMIT NË DETYRË

17. Gjyqtarët duhet të jenë të sigurt për qëndrimin në detyrë. Mandati i gjyqtarëve duhet të sigurohet në mënyrë të përshtatshme me ligj. Përdorimi i periudhës së provës në procesin e emërimit nuk preferohet, megjithatë aty ku ai ekziston, duhet të kufizohet sa më shumë të jetë e mundur. Një gjyqtar në periudhë prove gëzon të njëjtat mbrojtje, privilegje, imunitete dhe pavarësi personale si një gjyqtar i cili nuk është në provë.

18. Rekomandohet se të gjithë gjyqtarët që ushtrojnë të njëjtin juridiksion të emërohen për një periudhë që përfundon me arritjen e një moshe të caktuar.

19. Gjyqtarët duhet të japin dorëheqjen para kohe vetëm me kërkesën e tyre dhe duhet të largohen nga detyra vetëm për paaftësi të provuar, dënim për një krim, ose shkelje tjetër të rëndë që e bën gjyqtarin të papërshtatshëm për të qenë i tillë. Gjykimi i një çështje në themel, në mirëbesim, bazuar mbi zbatimin e ligjit nga gjyqtari, nuk duhet të çoj në largimin e tij, edhe pse vendimi i gjyqtarit mund të jetë i gabuar, i pambështetur nga opinioni publik ose i papranueshëm nga funksionarët dhe institucionet e qeverisë. Mjeti i përshtatshëm për ata që janë të pakënaqur me vendimin gjyqësor është ankimi i tij në përputhje me ligjin.

20. Gjyqtarët të cilët janë kryetar të dhomave nuk duhet të largohen si kryetarë bazuar në një gjykim të gjyqtarit ose të gjyqtarëve të tjerë të dhomës, i cili mendohet të jetë i gabuar, i pambështetur nga opinioni publik, ose i papranueshëm.

21. Aty ku nuk zbatohen procedurat për largimin e gjyqtarit me votën e popullit, procedurat për largimin e gjyqtarëve duhet të jetë nën kontrollin e gjyqësorit.

22. Në çdo rast shkarkimi të gjyqtarit, ai duhet të ketë të drejtën e njoftimit të përshtatshëm dhe të një seance dëgjimore të plotë dhe të drejtë. Asnjë gjyqtar nuk duhet të ndëshkohet disiplinarisht apo shkarkohet për veprimet gjyqësore, me përjashtim të rastit të pakujdesisë të rëndë apo mosrespektimit të qëllimshëm të ligjit.

23. Në qoftë se ligji parashikon vlerësimin e performancës profesionale të gjyqtarëve, ky vlerësim duhet të respektojë pavarësinë e gjyqësorit. Gjyqtarët mund të vlerësohen për të identifikuar fushat në të cilat ata duhet të përmirësohen dhe për të përcaktuar se kush duhet të ngrihet në detyrë. Me vlerësimet nuk duhet të abuzohet dhe të përdoren si pretekst për të shkarkuar një gjyqtar.

24. Të gjitha procedimet disiplinore, të pezullimit ose largimit duhet të kryen në përputhje me standardet e përcaktuara më parë për sjelljen e gjyqtarit, si dhe të jenë transparente.

25. Me përjashtim të rasteve për të siguruar gjykimin e duhur dhe në kohë të çështjeve, asnjë gjyqtar nuk duhet të transferohet nga organet kompetente përgjegjëse për administrimin e shërbimit gjyqësor nga një juridiksion ose funksion në një tjetër pa miratimin e gjyqtarit.

26. Nëse organi kompetent përgjegjës për administrimin e shërbimit gjyqësor është një këshill gjyqësor, një këshill drejtësie, ose një organ i ngjashëm, ky këshilli ose organ duhet të përbëhet nga shumica gjyqtarë.

KUSHTET GJYQËSORE

27. Gjyqtarët duhet të marrin të ardhura në përputhje me profesionin dhe përgjegjësitë e tyre dhe duhet t'u sigurohet qëndrimi dhe kushte të përshtatshme në detyrë. Gjyqtarëve duhet t'u sigurohet trajnim i duhur. Gjyqtarët duhet gjithashtu të pajisen me struktura të përshtatshme për të punuar, të cilat reflektojnë rëndësinë e shtetit të së drejtës në shoqëri. Gjykatat duhet të kenë me një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh dhe staf mbështetës të kualifikuar siç duhet. Të ardhurat e gjyqtarëve duhet të mbrohen nga pakësimi përmes legjislacionit specifik. Garancitë duhet të ekzistojë për ruajtjen e një shpërblimi të arsyeshëm të gjyqtarëve në rastet e paaftësisë, si dhe për pagesën e pensionit, që duhet të jenë në një masë të arsyeshme në raport me nivelin e shpërblimit të tyre kur punonin. Të ardhurat dhe kushtet e punës të gjyqtarëve nuk duhet të ndryshohen në dëm të gjyqtarëve gjatë afatit të detyrës së tyre, përveç në rast të një emergjence ekonomike apo buxhetore.

28. Pa paragjykuar asnjë procedurë disiplinore ose ndonjë të drejtë ankimi ose kompensim nga shteti në përputhje me ligjin kombëtar, gjyqtarët duhet të gëzojnë imunitet personal nga paditë civile dhe imunitet nga pagesa e dëmshpërblimit, bazuar në pretendime për veprime të parregullta ose mosveprime në ushtrimin e funksioneve të tyre gjyqësore. Asnjë gjyqtar nuk duhet të jetë subjekt i procedimeve penale për sjellje kriminale pa iu hequr imuniteti apo pa dhënë ai dorëheqjen prej tij. Megjithatë, duke qenë se asnjë gjyqtar nuk është mbi ligjin, sa herë që një gjyqtar përfshihet në sjellje kriminale, heqja dorë nga imuniteti duhet të jetë e pritshme.

JURIDIKSIONI

29. Gjyqësori duhet të ketë juridiksion mbi të gjitha çështjet e natyrës gjykimore dhe autoritet ekskluziv për të vendosur nëse një çështje e paraqitur për t'u shqyrtuar është brenda kompetencave të tij të përcaktuara me ligj.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

30. Kryetarët ose drejtuesit e gjykatave nuk duhet të kenë kompetencë ekskluzive për të marrë vendime administrative që mund të ndikojnë në pavarësinë e gjykimit të çështjeve të veçanta. Caktimi i çështjeve për gjyqtarët duhet të bëhet me short ose në bazë të kriterëve të qarta, objektive dhe transparente të paracaktuara nga një bord i gjyqtarëve të gjykatës.

31. Përgjegjësia kryesore për administratën gjyqësore, duke përfshirë emërimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin disiplinor të personelit administrativ dhe stafit mbështetës duhet ti përkasë gjyqësorit ose një organi kompetent në të cilin gjyqësori ka një përfaqësim shumice ose ndryshe, një rol efektiv në të.

32. Buxheti i gjykatave duhet të përgatiten nga gjykatat, ose një autoritet kompetent në bashkëpunim me gjykatat apo autoritetet gjyqësore, duke pasur parasysh nevojat e pavarësisë së gjyqësorit dhe administrimit të tij. Shuma e caktuar duhet të jetë e mjaftueshme për të mundësuar çdo gjykatë të funksionojë, pa vendosur një ngarkesë pune mbi çdo gjyqtar, e cila do të dëmtonte administrimin e shpejtë dhe efektiv të drejtësisë.

MARRËDHËNIA ME DEGËT LEGJISLATIVE DHE EKZEKUTIVE

33. Pushtetet legjislative dhe ekzekutive që mund të ndikojnë gjyqtarët në detyrën, shpërblimin ose kushtet apo burimet e tyre, nuk duhet të përdoren në mënyrë që të kërcënojnë ose të bëjnë presion mbi një apo disa gjyqtarë të caktuar, apo gjyqësorin në tërësi.

34. Autoritetet ekzekutive nuk duhet t'u ofrojnë gjyqtarëve avantazhe ose përfitime, as nuk duhet që këto avantazhe ose përfitime të pranohen nga gjyqtarët, në qoftë se ato mund të ndikojnë në kryerjen e funksioneve të tyre gjyqësore.

35. Autoritetet ekzekutive duhet gjatë gjithë kohës të garantojnë sigurinë dhe mbrojtjen fizike të gjyqtarëve dhe familjeve të tyre. Këto masa përfshijnë mbrojtjen e gjykatave dhe të gjyqtarëve të cilët mund të bëhen, ose janë viktime të kërcënimeve apo akteve të dhunës.

BURIMET

36. Degët legislative dhe ekzekutive duhet të respektojë autoritetin e gjyqësorit dhe, nëse komentojnë mbi vendimet e gjyqtarëve, duhet të shmangin kritikën që do të cenojnë pavarësinë apo besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Degët legislative dhe ekzekutive janë të detyruar të respektojnë vendimet e gjyqtarëve dhe duhet të shmangin veprime që mund të vënë në dyshim gatishmërinë e tyre për të respektuar vendimet e gjyqtarëve, përveç duke deklaruar synimin e tyre për të apeluar.

37. Gjyqtarët dhe autoritetet gjyqësore duhet të kenë të drejtën të luajnë një rol aktiv në përgatitjen e legjislacionit në lidhje me statusin e tyre dhe, më në përgjithësi, funksionimin e sistemit gjyqësor. Çdo projekt ligj në lidhje me statusin e gjyqtarëve, administrimin e drejtësisë dhe draft ligj tjetër që ka gjasa të ketë një ndikim mbi gjyqësorin, pavarësinë e gjyqësorit apo garancitë e aksesit të qytetarëve në drejtësi duhet të shqyrtohet nga dega legislative vetëm pas marrjes së mendimit të autoritetit kompetent të gjyqësorit.

38. Është thelbësore që gjyqtarët të pajisen me burimet e nevojshme që u mundësojnë kryerjen e funksioneve të tyre. Shteti është i detyruar që t'i sigurojë gjyqësorit këto burime.

MARRËDHËNIET ME MEDIAN

39. Media dhe gjyqësori mbështesin tek njëri tjetri: ashtu si gjykatat mbështesin të drejtën e mediave për të hetuar dhe publikuar informacione, media luan një rol të rëndësishëm në promovimin dhe ruajtjen e respektit publik për gjyqësorin. Gjyqësori njeh se e drejta e publikut për t'u informuar në lidhje me vendimet gjyqësore dhe llogaridhënien publike të gjyqtarëve ka nevojë për paraqitjen e përshtatshme mediatike të veprimeve dhe sjelljes gjyqësore. Për këtë qëllim proceset gjyqësore duhet të jenë transparente përveç kur konfidencialiteti kërkohet nga ligj.

40. Mediat duhet të respektojnë dhe mbështesin pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit dhe të vlerësojnë se mbështetja publike për gjyqësorin dhe vendimet gjyqësore është e nevojshme për funksionin gjyqësor dhe me përfitim të madh për shoqërinë.

41. Kritika e medias për gjyqtarët, veprimet gjyqësore dhe opinionet gjyqësore është e përshtatshme, me kusht që media të mos përpiqet që të ndikojë në bindjen e një gjyqtari apo të gjyqtarëve për të arritur një konkluzion të caktuar.

42. Mediat duhet të përmbahen nga kritika e padrejtë dhe e pabazuar ndaj gjyqësorit. Në çdo rast, kur kritikën nga mediat ndaj një gjyqtari ose vendimit të një gjyqtarit është e padrejtë apo e pabazuar, është e përshtatshme që të jepet një përgjigje në emër të gjyqtarit. Për shkak se një gjyqtar është i kufizuar nga komentimi publik i çështjeve gjyqësore, përgjigja duhet të jepet nga zëdhënësit e gjykatës, shoqatat e gjyqtarëve, shoqatat e avokatëve dhe subjekte të tjera jashtë gjyqësorit.